



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

Nga mbledhja e pestë e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 15.5.2025, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Arton Brahimi, Elmira Nikçi Rexha, Nenad Miladinovic, Tiera Kasumi Berisha, Oktay Kurtesh, Kimeta Shok, Faton Marolli.

Mungoi: Adnan Ajeti.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Klaudia Mula - zyrtare për komunitete në ZKKK, Arianita Beqa Raci - zyrtare nga UNMIK-u, Fisnik Dida - zyrtar nga OSCE-ja, si dhe përfaqësuesit e KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e komitetit znj. Mirsada Behluli me këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit të Komitetit për Komunitete;
2. Ftesë për Drejtorinë e Mirëqenies Sociale të Komunës së Prishtinës:
 - a) Raportimi mbi numrin e rasteve sociale nga komunitetet joshumicë - serb, ashkali, rom, boshnjak, turq dhe goran.
3. Ftesë për Drejtorinë e Investimeve Kapitale - analiza dhe zbatimi i projekteve të komunitetit joshumicë;
4. Ftesë për Drejtorinë e Arsimit;
5. Raportimi për vizitat në vendbanimet e komuniteteve joshumicë Bërnica e Poshtme, Bërnica e Epërme, Nëntë Jugoviq, Lebanë, Besi dhe Slivovë:
 - a) Njoftim për kërkesat përkatëse, nevojat e banorëve, kërkesat e projektit;
6. Përmirësimi i bashkëpunimit midis Zyrës për komunitete dhe anëtarëve të Komitetit për Komunitete;
7. Raporti i ZKKK-ës për muajin prill 2025;
8. Raporti i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë për situatën në komunitetin e tyre;
9. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit të Komitetit për Komunitete

Mirsada Behluli – duke ju kërkuar falje të pranishmëve lidhur me ekstraktin tha se për shkaqe teknike ekstrakti nuk ka mundur të përpilohet në tërësi.

Oktay Kurtesh – sa i përket pikës së parë të rendit të ditës tha se ka vërejtje lidhur me diskutimin e tij pasi që disa fjali të cilat janë cekur në ekstrakt nuk janë thënë nga ana e tij, si p.sh këtu përmendet Prizreni që ai nuk është përmendur fare vetëm se janë përmendur Mitrovica dhe Gjilani. Ai në vazhdim tha se ka kërkuar të ketë përkthyes nga gjuha shqipe në atë turke siç është në Komunën e Mitrovicës dhe Gjilanit.

Pika e dytë

Ftesë për Drejtorinë e Mirëqenies Sociale të Komunës së Prishtinës:

- a) **Raportoni mbi numrin e rasteve sociale nga komunitetet joshumicë - serb, ashkali, rom, boshnjak, turq dhe goran.**

Për shkak të mosprezencës së drejtoreshës apo ndonjë zyrtari tjetër kompetent nga drejtoria përkatëse, kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për njërën nga takimet e ardhshme.

Pika e tretë

Ftesë për Drejtorinë e Investimeve Kapitale - analiza dhe zbatimi i projekteve të komunitetit joshumicë

Nenad Miladinovic – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se kohëve të fundit me të vërtetë kemi probleme të mëdha për shkak të mosardhjes së zyrtarëve nga drejtoritë të cilat ftohen për takim. Ja p.sh vetëm sot i kemi pasur të ftuara tri drejtori prej të cilave nuk ka ardhur asnjë zyrtar kompetent. Ai në vazhdim tha se nëse vazhdohet tutje kështu mendoj se nuk kemi arsye të punojmë, prandaj i propozoj kryesueses që të bisedojë me kryesuesin e Kuvendit lidhur me këtë çështje pasi që është edhe pjesë përbërëse e Kuvendit ky komitet, e pastaj të bisedojë edhe me kryetarin e komunës.

Mirsada Behluli - tha se sa i përket kësaj pike të rendit të ditës ndoshta kishim mundur të diskutojmë me Nenadin e të shikojmë se deri ku ka arritur implementimi i projekteve të investimeve kapitale.

Nenad Miladinovic - sa i përket kësaj pike të rendit të ditës se deri ku ka arritur implementimi i projekteve mund t'ju them se për fat të keq që tri vite disa projekte kanë filluar të realizohen, por ende nuk kanë përfunduar, si p.sh asfaltimi i rrugës kryesore në Bërnice të Poshtme ku punimet kanë filluar qysh nga fundi i vitit 2022 e ende nuk kanë përfunduar. Pastaj janë bërë punë përgatitore, të cilat edhe ditën e sotme vazhdojnë për shkak të rregullimit të rrugës magjistrale Podujevë – Prishtinë, ndërsa projektet të cilat nuk janë realizuar njëra ndër to është furnizimi me ujë në fshatin Slivovë, etj.

Pika e katërt

Ftesë për Drejtorinë e Arsimit

Mirsada Behluli: – po ashtu edhe nga kjo drejtori nuk na është përgjigjur askush.

Ajo në vazhdim tha se posaçërisht dje e kam kontaktuar Artonin pasi që përkohësisht ka rolin e organizatorit, po ashtu kam ftuar Mirandën e cila punon në atë drejtori që mundësisht të na e dërgojë dikend nga zyrtarët kompetent apo të vijë edhe vetë ajo pasi që është pjesë e Drejtorisë së Arsimit, qysh kishin me na informuar lidhur me gjendjen në shkolla ku vijnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë.

Pika e pestë

Raportimi për vizitat në vendbanimet e komuniteteve joshumicë Bërnica e Poshtme, Bërnica e Epërme, Nëntë Jugoviq, Lebanë, Besi dhe Slivovë:

a) Njoftim për kërkesat përkatëse, nevojat e banorëve, kërkesat e projektit.

Slavica Stolic: – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës të pranishmit i informoi lidhur me vizitën në Bërnice të Poshtme, Bërnice të Epërme, Bardhosh (Nëntë Jugovic), Lebanë, Besi, Slivovë, Kisha ortodokse “Shën Nikolla” në Prishtinë etj. Ajo mes tjerash tha se gjatë vizitës në terren kanë hasur në disa probleme si p.sh deponi e madhe e mbeturinave në Bërnice të Poshtme, pastrimi i shtratit të lumit i cili duhet të pastrohet domosdo etj.

Pika e gjashtë

Përmirësimi i bashkëpunimit midis zyrës për komunitete dhe anëtarëve të Komitetit për Komunitete

Klaudia Mula: – tha se unë si përfaqësuese e Zyrës për Komunitete dhe përvojës sime me vite të tëra e kam bërë një analizë të bashkëpunimit tonë me përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë, dhe mendoj se kemi ndjekur disa hapa konkret rreth bashkëpunimit tonë siç janë: përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësi të secilës palë sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe akteve tjera nënligjore ku sqarohen kompetencat, takimet e rregullta mujore, planifikimi dhe koordinimi i aktiviteteve të përbashkëta, rritja e transparencës për shkëmbimin e informacioneve, përfshirja aktive e komuniteteve në vendimmarrje dhe përfaqësimi i tyre i drejtë dhe i barabartë në komitet duke u përkrahur nga Zyra për komunitete. Ajo mes tjerash tha se Zyra për komunitete angazhohet dhe ofron mbështetje administrative dhe profesionale, raporton rregullisht për aktivitetet dhe gjendjen e komuniteteve, ndërmjetëson në komunikimin me komitetet në terren dhe me drejtoritë tjera, ndërsa Komiteti për Komunitete angazhohet në organizimin e takimeve të rregullta për shqyrtimin e çështjeve të komuniteteve, jep rekomandime për Kuvendin komunal dhe drejtoritë komunale, si dhe sigurojnë përfaqësim të drejtë dhe gjithëpërfshirës.

Mirsada Behluli: – falënderoi znj. Klaudia për sqarimin e kësaj pike.

Pika e shtatë

Raporti i ZKKK-ës për muajin prill 2025

Klaudia Mula: – tha se sa i përket Raportit të ZKKK-ës për muajin prill 2025 tha se besoj se e keni lexuar të gjithë raportin dhe nuk do të isha ndalur në secilin aktivitet që është zhvilluar. Mirëpo ajo çka vlen të përmendet është ndërmjetësimi i komuniteteve në arritjen e marrëveshjes bashkëfinanciare në mes të Organizatës Ndërkombëtare për Emigrim IOM dhe kryeqytetit për financimin e kabineteve shkencore në shkollën fillore “Asim Vokshi”, shkollë në të cilën vijnë mësimin 50 nxënës të komuniteteve joshumicë. Ajo në vazhdim tha se ky pra është një sukses shumë i mirë, si dhe shuma që kemi fituar si bashkëfinancim është 10 mijë euro, ndërsa kryeqyteti ka bashkëfinancuar me 3 mijë e 774 euro.

Arianita Beqa Raci: - UNMIK - shtroi pyetje se kur planifikohet implementimi i projektit për kabinetet.

Klaudia Mula: – duke iu përgjigjur znj. Raci tha se shkolla i ka bërë përgatitjet e klasave, është proceduar kërkesa në Drejtorinë e Financave për me i alokuar mjetet, posa të alokohen mjetet do të implementohet projekti.

Pika e tetë

Raporti i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë për situatën në komunitetin e tyre
Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Pika e nëntë

Të ndryshme

Mirsada Behluli: – të pranishmit i informoi se duhet të formohet grupi punues për hartimin e raportit të punës gjashtëmujore të Komitetit për Komunitete. Prandaj kisha me ju lutur që nëse keni ndonjë problem apo shqetësim të themi të ri përveç atyre që i kam në dijeni t'i paraqitni qysh kishim me i futur në raport. Në vazhdim ajo të pranishmit i informoi se më dt.21.5.2025 OSCE-ja po organizon një konferencë në Prizren. Meqë më kanë ftuar mua si kryesuese e komitetit, por për shkaqe personale me siguri nuk do të mundem të marr pjesë, prandaj ju shtroj pyetjen se kush mund të shkojë në vendin tim.

Nenad Miladinovic: – sa i përket hartimit të raportit tha se Trieria dhe Klaudia e kanë punuar shumë mirë raportin e kaluar.

Fisnik Dida, OSCE: - aktiviteti që do të mbahet më dt.21.5.2025 nuk është konferencë, por është takim për shkëmbimin e eksperiencave me Komitetin për Komunitete të Komunës së Prizrenit. Do të thotë aty do të marrin pjesë të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë të regionit të Prishtinës. Prandaj na nevojiten edhe dy persona nga Komiteti për Komunitete nga Komuna e Prishtinës që të marrin pjesë në këtë takim.

Për takimin e caktuar më dt.21.5.2025 nga OSCE-ja u propozuan Nenad Miladinovic dhe Kimeta Shok.

Pas shumë diskutimesh dhe sugjerimesh Komiteti për Komunitete nxorri këtë

REKOMANDIM

Anëtarët e Komitetit për Komunitete patën vërejtje lidhur me mos përgjigjen e ca drejtorive si p.sh Drejtoria e Investimeve kapitale, Drejtoria e Arsimit të cilat u ftuan së paku tri herë në takim e nuk i janë përgjigjur ftesës.

Takimi i radhës do të mbahet më dt. 18.6.2025

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit
Dr. Mirsada Behluli

Faqe 4 nga 4

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://www.prishtina-komuna.org>

